



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI NË AUSTRI,
VITI AKADEMIK 2021-2022**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Austrisë, në fushën e arsimit, Ministria Austriake e Arsimit, Shkencës dhe Hulumtimit, ofron bursa për studentët, të diplomuarit dhe kërkuesit shkencorë të huaj, për vitin akademik 2021-2022.

Kandidatët e interesuar janë të lutur të njihen me informacione të detajuara në lidhje me bursat dhe mënyrën e aplikimit nëpërmjet thirrjes për aplikim dhe bazën e të dhënave austriake për bursa dhe financime kërkimore www.grants.at (në gjermanisht dhe anglisht).

Përveç bursave nga Ministria Austriake e Arsimit, Shkencës dhe Hulumtimit, gjeni gjithashtu informacione në lidhje me programet e bursave të institucioneve të tjera, si më poshtë:

1. OeAD ka hapur aplikimet për programet, [Ernst Mach-weltweit](#), [Franz Werfel](#) dhe [Richard Plaschka](#). Në këto programe mund të aplikojnë persona nga e gjithë bota.
2. [CEEPUS](#) dhe programet dypalëshe të veprimit janë të kufizuara sipas rajoneve.
3. [Bursa Marietta Blau](#), pranon aplikime nga aplikantë nga e gjithë bota dhe gjithashtu u mundëson studentëve të universiteteve austriake që ndjekin programe të Doktoraturës, të shkojnë jashtë vendit për të kryer në mënyrë optimale disertacionin e tyre.

Informacione më të detajuara në lidhje me programet e studimit në Austri mund të gjeni në faqen e internetit: www.studyinaustria.at.

Për rregullat dhe procedurat e pranimit, referojuni udhëzimeve përkatëse në faqet e sipërcituara të internetit.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS